

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Rekomandimet e KiE për paraburgimin, ministri Gogu: Po rishikojmë Kodin e Procedurës Penale
ADRESA	https://kohajone.com/lajme/rekomandimet-e-kie-per-paraburgimin-ministri-gogu-po-rishikoj-me-kodin-e-procedures-penale/
BURIMI	kohajone.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	18 shtator 2026, 09:18:14 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	18 shtator 2026, 09:15:08 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	e08dd86f80fcfb2928ecc96237ec20a20ea60f57cdb8ae854c39d7eb4a78dba
TEKSTI	a7c4860768a0935d1f13b4c30a9b364e83b3a6349c4eda4708f6b9bf61befead
PAMJA	e016beaf7f987bfec32a6c8016dfde553bacca6bedcaf8319d3a63a7f1fa6caa

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	a6d86f73dd9e2851f3c392634454e97294f11617f2ab8c19f28f808cb272731e
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	219f872b2d436154cbce21b1357d2a6f04cc2d43ba2a7914d91c1ebdf0665477
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/a6d86f73dd9e2851f3c392634454e97294f11617f2ab8c19f28f808cb272731e>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px


Rekomandimet e KiE për paraburgimin, ministri Gogu: Po rishikojmë Kodin e Procedurës Penale

LAJME E PREMTE, 18 SHTATOR 2026 11:15



Ministri i Drejtësisë, Toni Gogu, bëri të ditur sot se rekomandimet e Këshillit të Evropës për paraburgimin po ushqejnë drejtpërdrejt punën e nisur për rishikimin e Kodit të Procedurës Penale, me fokus forcimin e garancive për lirinë e personit dhe funksionimin real të alternativave ndaj arrestit në burg.

Duke folur në tryezën kushtuar masave të sigurimit, vendimit unifikues të Gjykatës së Lartë dhe jurisprudencës së GJEDNJ-së, Gogu theksoi se puna me Këshillin e Evropës po kalon nga rekomandimet te procesi i reformës.

**KOHA JONË**
Na ndiqni në YouTube

"Puna jonë me Këshillin e Evropës nuk mbaron me dokumentin që diskutojmë sot. Rekomandimet e tij po ushqejnë drejtpërdrejt punën që kemi nisur për rishikimin e Kodit të Procedurës Penale", deklaroi ministri.

Sipas Gogut, në këtë proces po shqyrtohen çështje që lidhen me kriteret për paraburgimin, arsyetimin e individualizuar të masës, shqyrtimin real të masave më pak kufizuese, aksesin në materialet mbi të cilat mbështetet kërkesa për masë sigurimi dhe forcimin e alternativave.

Ministri theksoi se drejtimi i reformës duhet të ruajë njëkohësisht efektivitetin e sistemit të drejtësisë penale dhe garancitë e procesit të rregullt e të lirisë së personit.

"Kapaciteti i shtetit për të hetuar dhe ndjekur penalisht duhet të mbetet i fortë. Por po aq të forta duhet të jenë garancitë e procesit të rregullt dhe mbrojtja e lirisë së personit. Njëra nuk fitohet duke dobësuar tjetrën", tha Gogu.

Krahas ndryshimeve ligjore, Ministria e Drejtësisë po punon për rikthimin në funksion të mbikëqyrjes elektronike, si një nga instrumentet që u jep gjykatave mundësi reale për zbatimin e masave alternative.

Gogu tha se është siguruar financimi i nevojshëm për vitin 2027 dhe se objektivi është që sistemi i mbikëqyrjes elektronike të jetë operacional në mars 2027.

"Një alternativë që shteti nuk e ofron realisht, nuk është alternativë. Kjo është përgjegjësi e ekzekutivit, jo e gjykatës", deklaroi ministri.

LAJMET KRYESORE



Presidenti Begaj dekreton ligjin për rritjen e pagave të gjyqtarëve dhe prokurorëve



BE kërkon kufizime më të repta për rrjetet sociale



Rama në Kuvend: Gjykatësit s'mund të kenë pagat më të larta në vend. KLGJ e KLP kanë dështuar



Berisha hedh dyshimin e madh: A e pagoi Hashim Thaçi projektin për ndryshimin e kufijve?



Reagon avokati i Hashim Thaçit


TË PËRZGJEDHURA



Hamilton mohon kategorikisht: "S'kam kërkuar ndryshime stafi te Ferrari"




Klopp thërret 4 lojtarë për Gjermaninë: "Krenaria kombëtare të mos u besohet njerëzve të gabuar..."



Berisha hedh dyshimin e madh: A e pagoi Hashim Thaçi projektin për ndryshimin e kufijve?



Edmond Spaho te Nikoll Lesi: PD ka mbaruar, nuk vjen ne pushtet!



Luka Modric konfirmon pjesëmarrjen me Kroacinë në Ligën e Kombeve

MË TË LEXUARAT

Sistemi parashikohet të mbështetet me personel të trajnuar, protokolle të qarta reagimi dhe raportimi ndaj gjykatës dhe prokurorisë, si dhe me forcimin e kapaciteteve të Shërbimit të Provës.

Ministri nënvizoi gjithashtu kufirin institucional mes ekzekutivit dhe gjyqësorit, duke theksuar se Ministria e Drejtësisë nuk ka rol në vendimin se çfarë mase sigurimi duhet të caktohet në një çështje konkrete.

"Gjykata e Lartë ka qartësuar standardin. Ne po punojmë që edhe kadri ligjor ta mbështesë atë dhe po ndërtojmë mbikëqyrjen elektronike e po forcojmë Shërbimin e Provës që alternativat të jenë reale dhe të besueshme. Ligj më i qartë. Alternativa reale. Institucione që funksionojnë. Kjo është pjesa që na takon ne", përfundoi Gogu.

MË SHUMË NGA LAJME



Rama mbledh ministrat dhe drejtuesit politikë të "Vila e kuqe&#...



Kuvendi miraton emërimin e Ervin Demos si ministër të Brendshëm, prit...



Kuvendi miraton me 84 vota rritjen me 2% të pagave të magjistratëve. ...



Klopp thërret 44 lojtarë për Gjermaninë: "Krenaria kombëtare të...



Shpejtësia po ua merr jetën të rinjve tanë, vdesin tre të rinjë



Edi Rama viziton Malin Athos, takohet me drejtuesit e Vatopedisë

LAJMET E FUNDIT



Sherri i dhunshëm në Sarandë. Dy vëllezërit plagosen brenda berberhanes, përleshja vijon edhe jashtë

18 MINUTA MË PARË



Ylli Manjani: Ku e lamë?! Te rregullorja

22 MINUTA MË PARË



Presidenti Begaj dekreton ligjin për rritjen e pagave të gjyqtarëve dhe prokurorëve

38 MINUTA MË PARË



A mund ta zhdukë vërtet inteligjenca artificiale njerëzimin? Gjashtë ekspertë shpjegojnë rreziqet

44 MINUTA MË PARË



U shoqëruan gjatë protestës para Parlamentit, lirohen 25 protestuesit

58 MINUTA MË PARË



Pagat e magjistratëve, SPAK nis hetimet. Merret në pyetje shefja e Thesarit

1 ORË E 12 MINUTA MË PARË

MË SHUMË LAJME TË FUNDIT >

KOHA JONE

Gazeta "KOHA JONE" themeluar si e pavarur më datë 11 Maj 1991
Botues: Nikoll LESI. Adresa e redaksisë: Rruga "Samë Frasheri", Pallatet e Aviacionit të Vjetër Nr. 2, TIRANA - ALBANIA

TË FUNDIT

LAJME

SPORTI

EKONOMI

EDITORIAL

WEBTV

AKTUALITET

RAJONI

KOSOVA

BOTA

TEKNOLOGJI

SHOWBIZ

SHËNDETI

SOCIALE

TURIZËM

KURIOZITETE

KULTURA

HISTORIKU

KONTAKT

BOTUES & DREJTOR: Nikoll LESI

KRYEREDAKTOR: Daniel MUÇAKU

ZV/KRYEREDAKTOR: Redjon SHTYLLA

BORDI: Elsa KAMBERI, KRYETARE

NIPT: J71425013C



NDËRTUAR DHE MIRËMBAHET NGA

SD

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.